



**KOMUNA E PRISHTINËS**  
**RAPORT MUJOR**

Drejtoria	<b>Drejtoria e Arsimit</b>
Periudha Raportuese	<b>Maj, 2020</b>
Emri dhe mbiemri i raportuesit	Fatos Osmani

### **1. PËRMBLEDHJE**

Përmbledhje e përgjithshme rreth mbarëvajtjes/ecurisë së punës në drejtorinë tuaj për muajin raportues.

Drejtoria e Arsimit gjatë muajit maj 2020, përkundër vështirësive të mëdha që ka shkaktuar përhapja e pandemisë Covid-19, ka arritur me punë dhe përkushtim të madh t'i realizon punë dhe detyra të shumta të parapara sipas planit të veprimit dhe punë dhe detyra të tjera të paraqitura gjatë kësaj periudhe kohore.

### **AKTIVITETET E PLANIFIKUARA**

Listoni aktivitetet për muajin raportues, të parapara sipas planprogramit të Komunës për drejtorinë tuaj:

- Mbikëqyrje të vazhdueshme të procesit edukativo-arsimor;
- Vizita të përgjithshme-këshilluese në institucionet arsimore;
- Përkrahja e shkollave për përmirësimin e performancës në bazë të rezultateve të vlerësimit të jashtëm;
- Formimi i Asociacionit të drejtorëve të shkollave, që funksionojnë si trup në sigurim të cilësisë;
- Mbikëqyrja/mentorimi i aktiveve profesionale (seksionet);

- Fuqizimi i aktiveve profesionale;
- Përmirësimi i planifikimit buxhetor (me të gjitha palët e interesit);
- Sigurohet buxheti adekuat për realizimin e objektivave të planit strategjik;
- Stimulimi i menaxhmentit (DKA - shkollë), mësimdhënësve të dalluar sipas performancës;
- Vizita studimore jashtë vendit për zyrtarët, drejtorët dhe mësimdhënësit, për të qenë në hap me ndryshimet dhe risitë arsimore në vendet e zhvilluara;
- Monitorimi i programeve të zhvillimit profesional;
- Krijimi dhe përditësimi i bazës së të dhënave për ZHPM;
- Organizimi dhe mbajtja e "Gara e diturisë", për nivelin e arsimit të mesëm të ulët;
- Organizohen punëtori të përbashkëta mes institucioneve relevante për identifikimin dhe tejkalimin e sfidave dhe problemeve në zbatimin e kurrikulës së re;
- Zbatimi i planit për tejkalimin e masave/ sfidave/ vështirësive/ pengesave;
- Zbatim i monitorimit të zbatimit të kurrikulës;
- Organizohen takime dhe punëtori për ndarje të përvojave e praktikave të mira në zbatimin e kurrikulave, me përfshirje relevante të shkollave (pilot) dhe palëve të interesit;
- Aftësimi dhe informimi i mësimdhënësve dhe i nxënësve lidhur me vlerësimin e standardizuar;
- Sigurohen dhe menaxhohen fondet për përmirësimin e infrastrukturës, në përputhje me kërkesat për zbatim optimal të kurrikulës së re. Kryesisht sigurohen pajisjet dhe mjetet materiale për mësimdhënie dhe të nxënë cilësor në klasat dhe vitet që zbatojnë kurrikulën e re;
- Identifikohen nevojat e shkollës për mjete të TIK-ut;
- Furnizimi i shkollave me pajisje të TIK-ut;
- Hartohen listat për nevojat e secilës shkollë për punëtori, kabinete /laboratorë dhe materiale shpenzuese;
- Identifikohen nevojat e mësimdhënësve për trajnime;
- Identifikimi i organizatave, bizneseve dhe komunitetit në përgjithësi që janë të interesuar të kontribuojnë në shkolla;
- Zbatimi i masave të programit për ndërtim, zgjerim, renovim dhe përmirësim të infrastrukturës së IP-ve;
- Zhvillimi i partneriteteve për rritjen e përfshirjes dhe sigurimin e kontributeve të jashtme;
- Zbatimi i programeve të trajnimit për edukim parashkollor;

- Aftësohet personeli për përdorimin e metodologjive pedagogjike në zbatim të KKK-së dhe KB-së në edukimin parashkollor (Montessori, Reggio Emilia, Hap pas Hapi, Majeutika);
- Angazhimi i psikologut, pedagogut, edukatorit mbështetës, pediatri, nutricionisti etj. në IP, me orar të organizuar sipas UA për numër të fëmijëve në IP;
- Operimi i ekipit vlerësues profesional për fëmijët me nevoja të veçanta arsimore;
- Integrimi i fëmijëve me nevoja të veçanta në institucione edukativo-arsimore;
- Monitorimi dhe integrimi i fëmijëve me nevoja të veçanta dhe rekomandimet për adresim më efektiv të problemeve;
- Organizimi i mësimi joformal në tri nivelet e arsimit (në bashkëpunim me MASHT dhe Qendrën Rajonale të Aftësimi Profesional);
- Hartimi i propozimit për MASHT për regjistrimin e nxënësve në shkollat e mesme në vitin shkollor 2019-2020;
- Analiza e trendit të regjistrimit të nxënësve dhe hartimi i propozimeve për regjistrim në vitin shkollor vijues;
- Sanksione të qarta dhe të zbatueshme për mësimdhënësit që ushtrojnë çfarëdo dhune dhe shkelje të të drejtave të fëmijëve në shkollë;
- Në nivel komunal dhe institucional, organizohen takime informative dhe konsultative me prindër dhe me komunitetin, me orar dhe agjendë të caktuara saktë;
- Takimet të rregullta individuale me prindër;
- Takime të rregullta me komunitetin;
- Angazhimi aktiv i prindërve në realizimin e kurrikulave;
- Angazhimi i prindërve në aktivitete jashtëkurrikulare;
- Prindërit angazhohen për krijimin e një mjedisi të sigurt në shkollë;
- DKA përkrahë NNV dhe nxënësit me talente;
- Përkrahja e punës së Ekipit Komunal për Vlerësim;
- Infrastrukturë afirmative për të nxënë efektiv;
- Indeksi i sigurisë;
- Ndërtimi i hapësirave të reja shkollore dhe renovimi e zgjerimi i hapësirave ekzistuese;
- DKA harton rregulloren për mjedis miqësor për të nxënë efektiv;
- Organizohen ngjarje për vetëdijesimin e punëtorëve arsimorë për nevojën e krijimit të kushteve optimale të punës e mësimi nëpër shkolla;
- Organizimi i takimeve me organet e sigurisë;
- Përgatitja e lëndëve të mbetura për pagesë;
- Furnizimi me inventar i disa shkollave;
- Përcjella dhe realizimi projekteve nga donatorët;

- Evidentimi i të hyrave vetanake;
- Nënaloqimet e pagave për institucionet shkollore;
- Nënaloqimet e mjeteve për mallra dhe shërbime në nënprograme;
- Shpenzimet komunale për institucionet shkollore;
- Pranimi i lëndëve për aprovim;
- Zotimi i lëndëve;
- Barazimi i pagesave me freebalance.

## 2. AKTIVITETET E IMPLEMENTUARA

Listoni dhe shpjegoni aktivitetet e implementuara gjatë periudhës raportuese nga drejtoria juaj, duke përfshirë edhe aktivitetet që janë në implementim e sipër. Theksoni të arriturat e Drejtorisë.

- Mbikëqyrja e organizimit dhe zhvillimit të mësimin në distancë në institucionet edukativo-arsimore në nivelin e arsimit parauniversitar, është duke u realizuar në vazhdimësi nga zyrtarët e arsimit, përmes platformave digjitale, duke i përcjellë ecuritë e zhvillimeve në arsim, dhe njëkohësisht duke i mbështetur shkollat me këshilla profesionale;
- **Mësimi në distancë**  
Drejtoria e Arsimit e Komunës së Prishtinës, në koordinim dhe bashkëveprim me Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit dhe mekanizma të tjerë mbështetës, kanë vazhduar me organizimin e mësimin në distancë, për nivelin e arsimit fillor (I-V) dhe nivelin e arsimit të mesëm të ulët (VI-IX) edhe gjatë muajit gusht 2020. Po ashtu, gjatë këtij muajit ka filluar edhe me zbatimin e lëndës së gjuhës angleze në mësimin në distancë për klasat 4-9;
- Përhapja e pandemisë Covid- 19, ka paraqitur vështirësi të mëdha në shumë dimensione dhe, në veçanti kjo ka reflektuar edhe në procesin edukativo-arsimor, ku më të filluar realizimi i procesit të mësimin online, është vërejtur se një numër i konsiderueshëm i nxënësve nuk kanë pajisje teknologjike për përcjelljen, gjegjësisht për të qenë pjesëmarrës në këtë proces. Andaj, për të dalë nga kjo



situatë, Komuna e Prishtinës ka bërë thirrje publike për mbështetje me pajisje teknologjike, ku kësaj thirrjeje iu përgjigjen shumë kompani, biznese dhe qytetarë të shumtë, duke dhuruar mbi 400 pajisje teknologjike (kompjuterë, laptopë dhe tabletë), për nxënësit tanë.

Andaj, zyrtarët e Drejtorisë së Arsimit, gjatë muajit maj kanë bërë shpërndarjen e pajisjeve teknologjike në institucionet edukativo-arsimore, mandej drejtuesit e shkollave i kanë shpërndarë te nxënësit që kanë nevojë, duke iu mundësuar që secili të vijojë mësimet në distancë;

- Psikologët e shkollave tona gjatë muajit maj kanë qenë aktivë në funksion të mbështetjes së nxënësve tanë me këshilla profesionale, dhe kjo është realizuar edhe me përkrahjen dhe mbështetjen e departamentit të psikologjisë të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina”.

Prandaj, Drejtoria e Arsimit në këtë pikë ka përcjellë informatat dhe adresat e nevojshme në institucionet arsimore, që të informohen të gjithë drejtorët, mësimdhënësit, prindërit dhe nxënësit për shërbimet që mund t’i marrin nga psikologët e shkollave, dhe nga aktorë të tjerë profesionalë të fushave të ndryshme që po kontribuojnë në këtë kohë pandemie;

- Drejtoria e Arsimit, gjatë muajit maj ka realizuar takim me drejtuesit e shkollave të viseve rurale, ku temë diskutimi ishte informimi për nxënësit të cilët nuk kanë qasje në internet dhe mundësia e kyçjes së tyre, në mënyrë që t’ju ofrohet mundësia e ndjekjes së mësimet në distancë;
- Komuna e Prishtinë në funksion të organizimit dhe lehtësimit të mbajtjes së mësimet në distancë, nga muaji maj ka filluar edhe me implementimin e platformës digjitale “e-Shkollori” në nivelin e arsimit (VI-IX), platformë që nënkupton menaxhim digjital të sistemit shkollor, duke ofruar këto shërbime: mbarëvajtjen e mësimet, mësimdhënies, mësimnxënies, notimi, vërejtjet, vlerësimet, statistika, raportime narrative, njoftimet;
- Në funksion të ngritjes së kapaciteteve dhe krijimit të kushteve më të mira në

vijueshmërinë e procesit edukativ, gjatë muajit maj është intervenuar në kopshtin “Shtëpia Magjike” - Besi, mbase numri i fëmijëve në këtë institucion është duke u rritur vazhdimisht, atëherë kanë filluar punimet për ndërtimin e aneksit për hapësirë shtesë dhe renovimin e tërësishëm të objektit ekzistues.



Edukimi i hershëm me kosto të përballueshme, është investimi i duhur që e bëjmë si shoqëri, për të siguruar gjithëpërfshirje dhe një të ardhme të sigurt për fëmijët tanë;

- Drejtoria e Arsimit, në funksion të krijimit të kushteve dhe mundësive më të mira për mësimdhënie dhe mësimnxënie, gjatë muajit maj ka filluar intervenimin e ndarjeve të hapësirave në paralelen e ndarë të shkollës fillor “Nëna Terezë” - Sharban, duke mundësuar që në këtë institucion mësimi të zhvillohet në një ndërrim dhe të krijohen hapësira për mësim kabinetik;



- Po ashtu, gjatë muajit maj është intervenuar në përmirësimin e infrastrukturës shkollore në këto institucione arsimore: IP “Lulevera”, SHFMU “Asim Vokshi”, SHFMU “Zenel Hajdini”, SHFMU “Nexhmi Mustafa”, SHFMU “Andon Z.Çajupi”, SHML “Xhevdet Doda” dhe SHML “Dr. Ali Sokoli”;
- Gjatë muajit maj, Drejtoria e Arsimit në koordinim me Zyrën e Bashkimit Evropian, kanë organizuar trajnimin për zhvillimin profesional të 220 mësimdhënësve, të nivelit fillor dhe parafillor të shkollave fillore: “Ismail Qemali”, “Hasan Prishtina”, “Meto Bajraktari”, “Zenel Hajdini”, Hilmi Rakovica”, “Naim Fashëri” dhe “Afrim Gashi”, në përdorimin e pajisjeve digjitale, përmes platformës Zoom;
- Drejtoria e Arsimit, gjatë muajit maj ka realizuar planifikimin për regjistrimin e fëmijëve në çerdhe, nxënësve në klasë të parë dhe në kasë të dhjetë (X), për vitin shkollor 2020-2021. Pra, planifikimi i regjistrimit të fëmijëve, nxënësve në institucionet edukativo-arsimore, është realizuar komform ligjeve dhe udhëzimeve administrative në fuqi që e rregullojnë këtë çështje;
- Si masë mbrojtëse nga virusi Covid-19, është realizuar riorganizimi i qendrave testuese për mbajtjen e Testit të arritshmërisë, pra organizimi dhe mbajtja e testit do të jetë komform rekomandimeve të institucioneve përgjegjës;
- Drejtoria e Arsimit, me kohë të duhur ka përcjellë Udhëzimin administrativ 08/2016, për vlerësimin e nxënësve sipas kornizës së Kurrikulës së arsimit parauniversitar të Republikës së Kosovës dhe njëkohësisht modelin sipas standardeve të kërkuara për vlerësim. Po ashtu, janë përcjellë edhe informata të tjera të domosdoshme në të gjitha institucionet e nivelit të arsimit parauniversitar dhe janë dhënë këshilla të nevojshme për këtë proces, por duhet theksuar se vlerësimi akoma mbetet sfidë dhe ka nevojë për mbështetje permanente;

- Takime të rregullta me zyrtarë për arsim në DKA, për të trajtuar çështje me interes e që ndërlidhen me ato të sigurisë në shkolla;
- Vizita në shkolla sipas kërkesave të shkollave;
- Takim me palët e interesit dhe zyrtarë komunalë nga drejtoritë tjera përkatëse;
- Shqyrtimi dhe kthimi i përgjigjeve të të gjitha shkresave zyrtare të paraqitura gjatë muajit maj;
- Pjesëmarrja në procedurat e hapjes dhe vlerësimeve të tenderëve për nevojat e institucioneve arsimore. Në procesin e hapjes dhe vlerësim të tenderëve marrin pjesë gjithnjë nga dy përfaqësues të Drejtorisë së Arsimit;
- Janë furnizuar në vazhdimësi të gjitha institucionet me materiale higjienike dhe mallra dhe shërbime tjera;
- Janë përcjellë të gjitha projektet të Zyra e prokurimit, për të vazhduar me procedura tjera;
- Furnizimi me inventar i disa institucioneve edukativo-arsimore;
- Nënaloqimet e pagave për institucionet shkollore;
- Nënaloqimet e mjeteve për mallra dhe shërbime në nënprograme;
- Shpenzimet komunale për institucionet shkollore;
- Pranimi i lëndëve për aprovim;
- Zotimi i lëndëve.

### 3. AKTIVITETET NË IMPLEMENTIM E SIPËR

Të përshkruhen në detaje aktivitetet që janë në implementim e sipër nga drejtoria juaj për muajin raportues:

- Vizita të vazhdueshme, të përgjithshme, kontrolluese dhe speciale në institucionet edukativo-arsimore;
- Formimi i Asociacionit të drejtorëve të shkollave, që funksionojnë si trup në sigurim të cilësisë;
- Monitorimi i programeve të zhvillimit profesional;
- Organizimi dhe mbajtja e garës "Gara e diturisë", për nivelin e arsimit të mesëm të ulët;
- Stimulimi i menaxhmentit (DKA - shkollë), mësimdhënësve të dalluar sipas performancës;
- Vizita studimore jashtë vendit për zyrtarët, drejtorët dhe mësimdhënësit, për të qenë në hap me ndryshimet dhe risitë arsimore në vendet e zhvilluara;

#### 3.1.1. STATISTIKAT

Të listohen të gjitha statistikat përkatëse për drejtorinë tuaj, duke filluar nga buxheti i planifikuar dhe ai i shpenzuar për periudhën raportuese, diskutimet publike, takimet me palë, institucione, qytetarë e të ngjashme, kërkesat për qasje në dokumente zyrtare, lëndët e pranuar, të kryera dhe në përfundim e sipër, dhe statistika të tjera specifike që mund të ketë drejtoria juaj. Shtoni kategoritë sipas nevojës.

### 3.1.2. Buxheti i planifikuar dhe ai i shpenzuar për periudhën raportuese, Maj 2020

<b>Buxheti i shpenzuar dhe alokuar maj-2020</b>				
<b>Kategoria eko.</b>	<b>Alokim</b>	<b>Shpenzim</b>	<b>Zotim -Oblig.</b>	<b>Mbetje -S=</b>
<b>Paga</b>	1,548,677.20	1,548,677.20	-	-
<b>Komunali</b>	178,568.38	45,986.04	4,842.32	127,740.02
<b>10-MSH</b>	408,172.51	138,396.16		269,776.35
<b>21-MSH</b>	246,101.71	-	50,541.89	195,559.82
<b>Subvencione</b>	93,490.00	60,040.00	-	33,450.00
<b>Donacione</b>	79,515.62	-	-	79,515.62
<b>Huaja-grant i BB</b>	-	-	-	-
<b>FB-21-Kapitale</b>	243,749.17	-	-	243,749.17
<b>FB-22-Kapitale</b>	2,988,914.11	187,001.99	-	2,801,912.12
<b>Totali:</b>	<b>5,787,188.70</b>	<b>1,980,101.39</b>	<b>55,384.21</b>	<b>3,751,703.10</b>

### 3.1.3. Takimet me palë:

- Drejtoria e Arsimit, gjatë muajit maj ka realizuar mbi 68 takime me palë;
- Takimet me palë në Drejtorinë e Arsimit janë të planifikuara katër ditë në javë.

## 4. Takimet me institucione të tjera

Për periudhën e muajit maj të vitit 2020, janë realizuar takime me:

- ministren e Arsimit dhe zëvendësministrat;
- zyrtarët e MASHTI-t;
- drejtorin e Inspektoratit të Arsimit;
- përfaqësuesit e KUR "Prishtina";
- përfaqësuesit e KEDS;
- përfaqësuesit e PTT-së.

### 4.1.1. Diskutime publike/takimet me qytetarë.

## 5. Kërkesat për qasje në dokumente zyrtare

- Gjatë muajit maj, në Drejtorinë e Arsimit nuk është adresuar asnjë kërkesë për qasje në dokumente zyrtare.



### 5.1.1. Lëndët e pranuar, të kryera dhe në përfundim e sipër

- Gjatë muajit maj janë pranuar gjithsej 167 lëndë, prej tyre të miratuara nuk ka pasur, të refuzuara 1 lëndë, të pezulluara 2 lëndë dhe në proces janë edhe 160 lëndë për paga jubilarë.

### 6. Takime të tjera

- Takime me drejtues të institucioneve edukativo-arsimore;
- Takime me mësimdhënës.

### 7. SFIDAT

Nëse gjatë implementimit të planeve është hasur në vështirësi të ndryshme, p.sh. pengesa brenda Drejtorisë, Komunës, apo institucioneve të ndryshme, ju lutem shpjegoni në këtë hapësirë:

- Riorganizimi dhe përcaktimi i përgjegjësive, punëve dhe detyrave në Drejtorinë e Arsimit;
- Mungesa e një stafit profesional e mbikëqyrës të veprimtarisë edukativo-arsimore;
- Mungesa e një mekanizmi për vlerësimin e performancës së stafit edukativo-arsimor;
- Mungesa e zyrtarëve ligjorë në Drejtorinë e Arsimit;
- Kompetenca të përziera dhe të paqarta.

### 8. REKOMANDIME

Shënoni rekomandime rreth përmirësimit të mbarëvajtjes së proceseve, nëse keni, dhe nevojave të drejtorisë për të gjitha aspektet, p.sh. trajnime të punëtorëve, furnizim me pajisje shtesë etj.:

- Riorganizimi i menjëhershëm i Drejtorisë së Arsimit, në bazë të përgjegjësive, punëve dhe detyrave që ka kjo drejtori;
- Plotësimi i stafit profesional sipas kërkesave dhe nevojave të Drejtorisë së Arsimit;
- Formimi i një organi mbikëqyrës të performancës së veprimtarisë edukativo-arsimore;
- Riorganizimi i rrjetit shkollor të viseve rurale të komunës së Prishtinës.

### 9. AKTIVITETET E PLANIFIKUARA PËR MUAJIN PASUES

Listoni aktivitetet e planifikuara për drejtorinë tuaj për muajin pasues:

- Mbikëqyrja e procesit edukativo-arsimor;
- Vizita sistematike në institucionet edukativo-arsimore;
- Vizita speciale IEAA;
- Vlerësimi i nevojave dhe sigurimi i personelit të kualifikuar për DKA dhe IEAA;
- Rishikimi dhe hartimi i kritereve për punësim;
- Përkrahja e shkollave për përmirësimin e performancës në bazë të rezultateve të vlerësimit të jashtëm;
- Formimi i Asociacionit të drejtorëve të shkollave që funksionojnë si trup në sigurim të cilësisë;
- Sigurimi i koordinatorit të cilësisë në nivel komune dhe në nivel shkolle;
- Mbikëqyrja/ mentorimi i aktiveve profesionale (seksionet);
- Fuqizimi i aktiveve profesionale;
- Nënshkrimi i marrëveshjeve për punë praktike;
- Përmirësimi i planifikimit buxhetor (me të gjitha palët e interesit);
- Sigurimi i buxhetit adekuat për realizimin e objektivave të planit strategjik;
- Stimulimi i menaxhmentit (DKA – shkollë), mësimdhënësve të dalluar sipas performancës;
- Vizita studimore jashtë vendit për zyrtarët, drejtorët dhe mësimdhënësit, për të qenë në hap me ndryshimet dhe risitë arsimore në vendet e zhvilluara;
- Vlerësimi i gjendjes përkitazi me funksionimin e paraleleve të ndara dhe shkollave të vogla rurale;
- Organizohen punëtori të përbashkëta mes institucioneve relevante për identifikimin dhe tejkalimin e sfidave dhe problemeve në zbatimin e kurrikulës së re;
- Zbatimi i planit për tejkalimin e masave/ sfidave/ vështirësive/ pengesave;
- Monitorimi i zbatimit të kurrikulës;
- Organizimi i takimeve dhe punëtorive për ndarje të përvojave e praktikave të mira në zbatimin e kurrikulave, me përfshirje relevante të shkollave (pilot) dhe palëve të interesit;
- Aftësimi dhe informimi i mësimdhënësve dhe nxënësve lidhur me vlerësimin e standardizuar;
- Sigurimi dhe menaxhimi i fondeve për përmirësimin e infrastrukturës, në përputhje me kërkesat për zbatim optimal të kurrikulës së re. Kryesisht sigurohen pajisjet dhe mjetet materiale për mësimdhënie dhe të nxënë cilësor në klasat dhe vitet që zbatojnë kurrikulën e re;
- Identifikimi i nevojave të shkollave për mjete të TIK-ut;
- Furnizimi i shkollave me pajisje të TIK-ut;
- Identifikohen nevojat e mësimdhënësve për trajnime;

- Identifikimi i organizatave, bizneseve dhe komunitetit në përgjithësi, që janë të interesuar të kontribuojnë në shkollë;
- Zbatimi i masave të programit për ndërtim, zgjerim, renovim dhe përmirësim të infrastrukturës së IP-ve;
- Rritja e llojeve të shërbimeve (dhe gjenerimi i të hyrave për rritje të numrit të fëmijëve të përfshirë në IP) të edukimit parashkollor;
- Zhvillimi i partneriteteve për rritjen e përfshirjes dhe sigurimin e kontributeve të jashtme;
- Vlerësimi i nevojave dhe kërkesave për zhvillim profesional të edukatoreve dhe personelit administrativ;
- Zbatimi i programeve të trajnimit për edukim parashkollor;
- Aftësohet personeli për përdorimin e metodologjive pedagogjike në zbatim të KKK dhe KB në edukimin parashkollor (Montessori, Reggio Emilia, Hap pas Hapi, Majeutika);
- Angazhimi i psikologut, pedagogut, edukatorit mbështetës, pediatri, nutricionisti etj. në IP, me orar të organizuar sipas UA për numër të fëmijëve në IP;
- Përkrahja për përmirësimin e zbatimit të standardeve të EPSH-së;
- Operimi i ekipit vlerësues profesional për fëmijët me nevoja të veçanta arsimore;
- Integrimi i fëmijëve me nevoja të veçanta në institucione edukativo-arsimore;
- Monitorimi dhe integrimi i fëmijëve me nevoja të veçanta dhe rekomandimet për adresim më efektiv të problemeve;
- Organizimi i mësimi joformal në tri nivelet e arsimit (në bashkëpunim me MASHT dhe Qendrën Rajonale të Aftësimi Profesional);
- Sanksione të qarta dhe të zbatueshme për mësimdhënësit që ushtrojnë çfarëdo dhune dhe shkelje të të drejtave të fëmijëve në shkollë;
- Në nivel komunal dhe institucional, organizohen takime informative dhe konsultative me prindër dhe me komunitetin, me orar dhe agjendë të caktuara saktë;
- Takimet të rregullta individuale me prindër;
- Takime të rregullta me komunitetin;
- Angazhimi aktiv i prindërve në realizimin e kurrikulave;
- Angazhimi i prindërve në aktivitete jashtëkurrikulare;
- Prindërit angazhohen për krijimin e një mjedisi të sigurt në shkollë;
- DKA përkrahë NNV dhe nxënësit me talente;
- Përkrahja e punës së Ekipit Komunal për Vlerësim;
- Infrastrukturë afirmative për të nxënë efektiv;
- Indeksi i sigurisë;

- Ndërtimi i hapësirave të reja shkollore dhe renovimi e zgjerimi i hapësirave ekzistuese;
- DKA harton rregulloren për mjedis miqësor për të nxënë efektiv;
- Organizohen ngjarje për vetëdijesimin e punëtorëve arsimorë për nevojën e krijimit të kushteve optimale të punës e mësimit nëpër shkolla;
- Organizimi i takimeve me organet e sigurisë;
- Përcjella dhe realizimi i projekteve nga donatorët;
- Evidentimi i të hyrave vetanake;
- Nënaloqimet e pagave për institucionet shkollore;
- Nënaloqimet e mjeteve për mallra dhe shërbime në nënprograme;
- Shpenzimet komunale për institucionet shkollore;
- Pranimi i lëndëve për aprovim;
- Zotimi i lëndëve.

## **10. TË TJERA**

Shënoni çështjet tjera që mendoni se janë me rëndësi të raportohen e që nuk kanë qenë të përfshira në pikat e mësipërme.